POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Mbahet në Universitetin e Korçës, aktiviteti në kuadër të prezantimit të 'Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe'

2 Pozicioni vakant në Kategorinë e Parë, KE e Federatës vendos që Kukësi dhe Butrinti të përballen në finalen 'play-off'

3 Deputeti i PD: Ne vetëm të marrim kallashin dhe t'i dilnim përpara Ramës, vetëm ajo ka ngelur për t'u bërë

4 Integrimi në BE, PD dorëzon amendamentet në Kuvend: Forcim i kontrollit parlamentar mbi qeverinë, refuzim të çdo veprimi që devijon procesin

5 Ministri Hoxha takon homologun ukrainas: Në qershor Tirana mirëpret ministerialin për Ukrainën

Kronikë

Operacion antidrogë në Maliq/ Zbulohet 'shtëpi bari' poshtë kotecit të pulave, një i arrestuar dhe një në kërkim! I prangosuri, i dënuar më parë për vrasje (EMRI)

Ambienti ishte i pajisur me sisteme të ndryshme ventilimi, ndriçimi dhe ngrohjeje, përfshirë llampa elektrike të posaçme, pajisje për rregullimin e temperaturës dhe lagështirës, si dhe tubacione për qarkullimin e ajrit. Po ashtu ishte instaluar edhe një sistem furnizimi me ujë dhe një sistem i organizuar për ujitjen e bimëve.

■ 'Shtëpia e barit' poshtë kotecit të pulave në Maliq, i arrestuari Klisman Leka i dënuar më parë për vrasje

Kotec pulash, foto ilustruese

Redaksia
11 Maj, 16:06 | **Përditësimi: 11 Maj, 18:21**

Share Post

Një operacion antidrogë është finalizuar me sukses në fshatin Vreshtas të Maliqit, ku është zbuluar një ambient i fshehtë për kultivimin dhe tharjen e bimëve narkotike cannabis sativa.

Operacioni u krye nën drejtimin e Prokurorisë së Korçës, e cila përmes një njoftimi bën të ditur se ambienti për kultivimin dhe tharjen e bimëve narkotike u zbulua poshtë një koteci pulash.

Po ashtu bëhet e ditur se në pranga gjatë këtij operacioni ra Klisman Leka, i dënuar më herët për 'vrasje me dashje', ndërsa një tjetër u shpall në kërkim.

Gjatë kontrolleve u sekuestruan rreth 5.4 kg lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa në forma të ndryshme (në proces tharjeje dhe e paketuar në doza të vogla), një sasi e vogël e dyshuar lëndë narkotike kokainë, pajisje të ndryshme për kultivimin dhe përpunimin e lëndës narkotike (vazo, llampa ndriçimi, sistem ventilimi, peshore elektronike), si dhe një armë në formën e pistoletës me bombol gazi të kompresuar.

Ndërkohë Prokuroria vijon hetimet për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale dhe për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë.

Njoftimi i Prokurorisë së Korçës:

Kultivonin dhe përpunonin lëndë narkotike në Maliq të fshehur pas një koteci shpendësh, hetimet proaktive të Prokurorisë Korçë çojnë në arrestimin e një shtetasi, një tjetër në kërkim

Hetimet proaktive të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëk Korçë, çuan në arrestimin e shtetasit K.L., i dyshuar për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", e kryer në bashkëpunim, ndërsa është shpallur në kërkim një person tjetër i dyshuar për disa vepra penale

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, në kuadër të hetimeve të zhvilluara me përdorimin e metodave proaktive hetimore, drejtoi dhe koordinoi veprimet procedurale që çuan në goditjen e një rasti të kultivimit dhe përpunimit të lëndëve narkotike në fshatin Vreshtas, Bashkia Maliq.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë dhe Seksionin për Hetimin e Narkotikëve, gjatë kontrolleve të ushtruara u zbulua një ambient i fshehtë i ndërtuar nën një kotec shpendësh, i maskuar dhe i përshtatur posaçërisht për kultivimin dhe tharjen e bimëve narkotike cannabis sativa. Hyrja në këtë ambient realizohej përmes një hapësire të improvizuar, e cila të çonte në një dhomë të ndërtuar nën tokë.

Nga këqyrja e këtij ambienti rezultoi se ai ishte organizuar në mënyrë profesionale, me mure të veshura me materiale termoizoluese, të përshtatura për ruajtjen e temperaturës dhe lagështirës. Ambienti ishte i pajisur me sisteme të ndryshme ventilimi, ndriçimi dhe ngrohjeje, përfshirë llampa elektrike të posaçme, pajisje për rregullimin e temperaturës dhe lagështirës, si dhe tubacione për qarkullimin e ajrit. Po ashtu ishte instaluar edhe një sistem furnizimi me ujë dhe një sistem i organizuar për ujitjen e bimëve.

Në këtë hapësirë u konstatuan zona të veçanta të përshtatura për tharjen e bimëve, ku bimë të të dyshuara cannabis sativa ishin të varura në struktura të improvizuara. Në dysheme janë gjetur dhjetëra vazo të mbushura me dhe, me mbetje kërcelli të bimëve të prera, si dhe materiale dhe pajisje ndihmëse për kultivimin dhe përpunimin e lëndës narkotike.

Nga veprimet hetimore u sekuestruan rreth 5.4 kg lëndë e dyshuar narkotike cannabis sativa në forma të ndryshme (ë proces tharjeje dhe e paketuar në doza të vogla), një sasi e vogël e dyshuar lëndë narkotike kokainë, pajisje të ndryshme për kultivimin dhe përpunimin e lëndës narkotike (vazo, llampa ndriçimi, sistem ventilimi, peshore elektronike), si dhe një armë në formën e pistoletës me bombol gazi të kompresuar.

Gjithashtu, nga verifikimet rezultoi se ambienti furnizohej me energji elektrike në mënyrë të paligjshme, përmes lidhjes direkte me rrjetin e shpërndarjes.

Prokuroria vijon hetimet për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale dhe për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 18:15

'Shtëpia e barit' poshtë kotecit të pulave në Maliq, i arrestuari Klisman Leka i dënuar më parë për vrasje

Klisman Leka i arrestuar nga policia e Korçës për kultivim të lëndëve narkotike në një ambient të stimuluar në zonën e Maliqit, sipas Policisë është një emër i njohur për drejtësinë pasi, më herët ka qënë i dënuar për 'vrasje më dashje' disa vite më parë.

Ai sëbashku me një shtetas tjetër kishin përshtatur një ambient (kotec pulash, me kat nëntokësor) për të kultivuar lëndët narkotike në zonën e Maliqit.

Arrestimi i tij u bë pas hetimeve të vazhdueshme dhe informacioneve në rrugë operative të cilat sinjalizuan për veprimtarinë që Klisman Leka sëbashku me një shtetas tjetër tashmë në kërkim po kryenin në një ambient të vogël, i cili ishte ndërtuar nën tokë me hyrje nga koteci i pulave.

Aty është gjetur sasia prej 5.4 kg lëndë narkotike e gatshme për t'u shitur dhe një pjesë e lëndës narkotike në përpunim. Menjëherë është bërë arrestimi i këtij shtetasi. Ndërkohë një tjetër shtetas është shpallur në kërkim.

R.Xh/Shqiptarja.com

Share

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: Korce operacion antidroge kanabis maliq

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

Sondazhi i ditës: 9 Maj, 13:00

PS propozon masa më të ashpra për shoferët e dehur e ata të rinj, si iu duket?

E drejtë E gabuar Nuk e di

Lajme të tjera

'Shtëpia e barit' poshtë kotecit të pulave në Maliq, i arrestuari Klisman Leka i dënuar më parë për vrasje
11 Maj, 18:15

'Më jep lekët ose të vrava', kanosi me thikë menaxherin e supermarketit në Korçë, arrestohet 40-vjeçari (EMRI)
11 Maj, 14:10

Garat me pëllumba sportiv, debat e protesta në doganë! KOKSH funksion sipas miqve (VIDEO)
Armand Braho
11 Maj, 10:11

Korçë/ Dyshohet se ngacmoi seksualisht 21-vjeçaren, arrestohet kirurgu
11 Maj, 09:25

Korça mirëpret ekspozitën për arumunët e Ballkanit, 100 fotografi mbi historinë dhe identitetin
Armand Braho
10 Maj, 15:08

Kryeministri Mickovski në ceremoninë përkujtimore në Pustec, thirrje për ruajtjen e identitetit maqedonas: Vetëm të bashkuar mund ta ruajmë vendim tonë
10 Maj, 11:46

AMBULANCE
URGJENCA
127/112

Është pranverë në Megatek deri në -52% më lirë

Është pranverë në Megatek
deri në -52% më lirë
megatek
Bëje mirë. Bëje vetë.